

20111342962

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE SIPAS MARREVESHJES FINANCIARE, TË DEDIKUAR PËR FINANCIM TË NDERMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE PROJEKTEVE TJERA PRIORITARE-FAZA II, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKES INVESTUESE EVROPIANE DHE BANKES MAQEDONASE PËR MBESHTETJEN E ZHVILLIMIT

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave nga Marrëveshja financiare, që do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit për Projektin për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare - faza II, në shume prej 50 000 000 eurosh, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshje financiare, nëse Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit nuk i shlyen dhe servison detyrimet nga Marrëveshja financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje financiare, që do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit për Projektin për financim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare - faza II.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që dalin nga Marrëveshja financiare nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i përmbushë Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të percaktuara në Marrëveshje financiare.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet në më së shumti 12 transhe. Shuma minimale e transhesë është 3 000 000 euro.

Afati i pagesës së çdo transheje të huas mund të jetë nga së paku katër vjet në më së shumti tetë vjet nga data e terheqjes së transhesë, me grejs periudhë të përfshirë prej më së shumti dy vitesh nga data e tërheqjes së transhesë.

Afati i pagesës së huas do të përcaktohet për secilën transhe veç e veç nga dita e dorëzimit të kërkesës për terheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njehershme në ditën që është ndërmjet tre dhe pesë vitesh nga dita e tërheqjes së transhesë.

Neni 5

Shkalla kamatare do të përcaktohet për secilën transhe të huas veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për terheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit, varësisht nga ajo se cila shkallë kamatare është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse apo variable).

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marrëveshja financiare dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit do të lidhin marrëveshje të vecante.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.